ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: KOMUNA E PEJES

Nr.1 i prokurimit	**635-24-4883-2-2-1**
Nr i brendshëm	**635-24-032-221**

Sa i përket tenderit për: **077 Regjistrimi dhe Sigurimi i Automjeteve**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

KOMPANIA E SIGURIMEVE PRISIG SH.A.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr.Eduard Lir Ob-2,Lagja Arbëria
(Adresa)

Prishtinë ***10000***
(Vendi) *(Kodi postar)*

038-221-000
(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

Besarb Blakaj
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@prisig-ks.com
(Adresa elektronike)

18.06.2024

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

_____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë: 20.05.2024 Data e hapjes së ofertave: 29.05.2024 Njoftimi mbi vendimin 06.06.2024 Kërkesa për rishqyrtim me dt:11.06.2024 Vendim për refuzim të kërkesës për rishqyrtim: 12.06.2024

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [X] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 52 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 40 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik
Tarifat e Bankës Qendrore të Kosovës

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Ne kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së B58 ku është rekomanduar për kontratë OE **SCARDIAN " J.S.C.** në vlerë totale të ofertës: **84,296.95,** ndërsa ne kemi pranuar letrën standarde për tenderues të pasuksesshëm.
Pas pranimit të njoftimit mbi vendimin, ne kemi kërkuar qasje në dokumente, ndërsa kemi vërejtur se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm me arsyet si më poshtë:

OE i rekomanduar për kontratë nuk ka respektuar tarifat obligative të BQK-së.

Për **veturat** me nr. rendor **20, 21** dhe **28**, OE "Scardian" ka thyer tarifat e aprovuara te BQK-së.

OE Scardian ka shkelur tarifat te Grupit Tarifat - **Autobus Urban dhe Autobus Nderurban**. Ofertimi me çmime me te ulëta se sa tarifat e BQK-së, normalisht që ka reflektuar edhe te çmimi TPL+, e që për këtë arsye OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmim më të ulët se sa kompania jonë dhe kompanitë tjera.

- **Automjeti me pozicion 20.**
  OE Scardian ka ofertuar me çmim **460 Euro primi baze**, ndërsa bazuar ne tarifat e BQK primi baze për autobusët ndër urban është **470 Euro** + 5Euro për çdo ulëse (40 Ulëse) + TVSH, ne kemi ofertuar me çmim 670Euro primi baze duke përfshirë edhe ulëset.

- **Automjeti me pozicion 21.**
  OE Scardian ka ofertuar me çmim **422 Euro** primi baze, ndërsa bazuar ne tarifat e BQK primi baze për autobusët ndër urban është 470 Euro + 5Euro për çdo ulëse (40 Ulese) + TVSH, ne kemi ofertuar me çmim 575Euro primi baze duke përfshirë edhe ulëset.

- **Automjeti me pozicion nr. 28**
  OE Scardian ka ofertuar me çmim 408 Euro primi baze, ndërsa bazuar ne tarifat e BQK primi baze për autobusët ndër urban eshët 470 Euro + 5Euro për çdo ulëse (40 Ulëse) + TVSH, ne kemi ofertuar me çmim 540Euro primi baze duke përfshirë edhe ulëset.

Për te shikuar tarifat e aplikueshme të gjitha kompanive te Sigurimeve, te publikuara ne web faqen e BQK ju lutem shiqoni linkun e bashkëlidhur - https://bqk-kos.org/mbikeqyrja-financiare-2/mbikeqyrja-e-sigurimeve/tarifat-dhe-buletini-statistikor/.
Nëse edhe ne, do ti kishim shkel tarifat BQK-së atëherë mund të ofertonim me çmim më të ulët, mirëpo një gjë e tillë nuk lejohet.

Gjithashtu OE Scardian ka shkelur edhe tarifat e Ministrisë se Punëve te Brendshme te Departamentit te QRA - Qendra e Regjistrimit te Automjeteve.

OE Scardian ka thyer tarifat tek **veturat** me nr. rendor: **30, 33, 38, 39, 47, 73** dhe **74**.

Për veturat me peshë më të ulët se **3.5 T** çmimi është 30 Euro, ndërsa për veturat me peshë **mbi 3.5T** çmimi është 50 Euro taksa administrative, 90.00 Euro taksa rrugore dhe 30.00 Euro taksa ekologjike, ndërsa për automjetet me pesha me te ulëta se 3.5T janë 25.00 Euro taksa administrative, taksa rrugore 40.00 Euro dhe taksa ekologjike 10.00Euro.

Ju lutem analizojeni këto fakte që po i cekim në këtë ankesë, në të kundërtën ne jemi të detyruar të vazhdojmë me procedura të tjera.

Në nenin 7.1&7.2 të FDT-së është kërkuar:

Kërkesa 3 Licenca për veprimtarinë e regjistruar – te kësaj natyre prej BQK-së

Dëshmia 3 Kopje te Licences për veprimtarinë e regjistruar – të kësaj natyre prej BQK-së.

Nga kjo kërkesë kuptohet qartë se për të gjitha kompanitë e sigurimeve që ofertojnë duhet të posedojnë licencën për veprimtari në BQK, prandaj edhe duhet ti nënshtrohen çdo herë rregullave dhe tarifave të BQK-së, në të kundërtën pasojnë ndëshkimet dhe pasojat për këto kompani.
Rregullat dhe tarifat e BQK-së vlejnë për të gjitha kompanitë, prandaj edhe duhet respektuar dhe zbatuar ato.

OE i rekomanduar për kontratë ka shkelur të gjitha këto tarifa, prandaj ka rezultu të jetë me çmim më të ulët, kështu që ky OE është i papërgjegjshëm.

Ne me dt. 12.06.2023 kemi marrë përgjigje në kërkesën për rishqyrtim ku autoriteti kontraktues ka deklaruar se refuzohet kërkesa për rishqyrtim, mirëpo nuk ka dhënë asnjë përgjigje faktike dhe ligjore në pretendimet tona ankimore.
Arsyetimi i AK-së ka qenë si më poshtë:

Pergjegjia nga A,K 1,

Ju njoftojm se ne si A,K dhe Komisioni Vlersues ju njofton se ka vepruar konform LPP-se , FDT-se dhe RREGULLORE Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK.
Fillimisht ju njoftojm se Vlera e Parashikuar e keti AP ka qene 86.317.17 € per 36 Muaj , dhe ju ne oferten e ofruar me daten 29.05.2024 keni oferua vleren prej 87.258.15 € per 36 Muaj qe i bije te jete 940.98 Euro te jete mbi vleren e parashikuar te AK, dhe ju si OE jeni mbi vleren e parashikuar te AK.

OE i rekomanduar per Kontrat ka ofruar qmimin me te ulet dhe eshte ne konform FDT-se te AK KK Peje, pasi qe komisioni vlersues ka konstatuar qe OE i rekomanduar per kontrat ka plotesuar te gjitha dokumentet e kerkuar ne FDT-se dhe eshte operator i pergjegjeshem me qmimin me te ulete, andaj ne si AK kemi shperblyer nje OE te pergjegjeshem i cili i ploteson te gjitha kushtet e FDT-se dhe eshte ne konform LPP-se dhe ka ofruar cmimin me te lire.
andaj me keqardhje ju njoftojm se pretendimet e juaja jan te pa bazuara.

Siç shihet nga kjo përgjigje, autoriteti kontraktues nuk ja dhënë asnjë përgjigje në lidhje me pretendime tona ankimore se OE i rekomanduar për kontratë i ka shkelur tarifat e BQK-së, mirëpo është shmangur përgjigjes në këtë pretendim.
AK-së e ka cekur se OE i rekomanduar për kontratë është me çmim më të ulët dhe kinse i plotëson të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit, mirëpo ne e kemi sqaruar shumë qartë në kërkesë për rishqyrtim e edhe tani në ankesë, se ky OE ka ofertuar me çmim më të ulët pikërisht për shkak të shkeljes së tarifave të BQK-së, prandaj është dashur të trajtohen pretendimet tona ankimore në aspektin e mos respektimit të tarifave të BQK-së.
Mos përgjigja në pretendimin tonë ankimor përkitazi me shkeljet e tarifave të BQK-së, tregon qartë se autoriteti kontraktues në mënyrë implicite e ka pranuar se tarifat janë shkelur, prandaj OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm dhe është dashur të eliminohet nga konkurrenca.
S ai përket çështjes se ne kemi ofertuar me çmim mbi vlerën e parashikuar, sqarojmë se ne jemi shpallur tenderues i pasuksesshëm, prandaj ky pretendim i AK-së nuk gjen zbatim në këtë rast.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe nenit 40 të RRPP Nr.001/2022, kurse njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, duke na diskriminuar neve si operator ekonomik, ndërsa paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që "Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse", mirëpo autoriteti kontraktues nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore, pasi që është rekomanduar për kontratë një OE i papërgjegjshëm

Po ashtu, autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të merr:

VENDIM

APROVOHET ankesa e **OE "KOMPANIA E SIGURIMEVE PRISIG SH.A"** si e bazuar,
ANULOHET, njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) për dhënie të kontratës dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM,**
DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, në vlerë prej 2,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*